

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: QIRAMARRJE AUTOMJETESH**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 60171000-7.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3,500,000 (Tre milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në Shtojcën 8, pika 1 të DST.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 8 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 datë 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 19 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme, dhe në përputhje me objektin e prokurimit), si më poshtë:

SH EN ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente / të barazvlefshme.

Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë, si sistem i lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit.

Standardi ISO 9001:2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” është i nevojshëm pasi garanton Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik disponon procedura të menaxhimit të cilësisë për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duke siguruar mirëmbajtjen, sigurinë, funksionalitetin dhe gatishmërinë operative të automjeteve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër pajisjen e mjetit me siguracionin e nevojshëm, për të gjithë periudhën e qirasë së plotë operacionale.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se do të mbulojë të gjitha detyrimet në lidhje me institucionet përkatëse (taksa rrugore / qarkullimi të vitit përkatës / etj).

**Argumentim për kriteret 2.3.3 dhe 2.3.4:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 pika 3 dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Duke qenë se Operatori ekonomik është pronari i automjeteve që vendos në dispozicion, të gjitha detyrimet që lidhen me automjetin janë pagesë e tij, është thelbësore për garantimin e një shërbimi të sigurt dhe pa kosto shtesë. Këto kushte vendosin përgjegjësi të qarta mbi operatorin ekonomik dhe garantojnë një shërbim të pandërprerë gjatë zbatimit të kontratës.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skedën teknike / broshuren / katalogun teknik / fragmente të tyre, me qëllim krahasimin e specifikimeve të mjeteve të ofruara në përputhje me specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 pika 6, germa b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter siguron verifikimin e përputhshmërisë së mjeteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në DST, duke garantuar që automjetet e propozuara plotësojnë kërkesat funksionale dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kontratës dhe të jetë e specifikuar adresa e ambientit.

- Në rast se shërbimi i riparimit apo mirëmbajtjes së mjeteve do të kryhet përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, ofertuesi duhet të dorëzojë kontratën e bashkëpunimit, ku të jetë e specifikuar adresa e servisit dhe afati i kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Bazuar në natyrën e shërbimit dhe nevojën për garantimin e funksionalitetit dhe sigurisë së automjeteve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, disponimi i një ambienti për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve është i nevojshëm për të siguruar realizimin e pandërprerë të shërbimit, mirëmbajtjen periodike si dhe ndërhyrjen në kohë në rast difektesh apo problematikash teknike.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike për mjetet e kërkuara dhe lëvrimin të shërbimit janë përcjellë pranë OBP të hartuara nga grupi i punës i përcaktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “Spitali Rajonal Memorial Fier” për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike/termat e referencës janë pjesë e pandashme e DST.

NJËSIA E PROKURIMIT